

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË
“INFINITY HOLDING” sh.p.k

TITULLI I
THEMELIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

NENI 1

THEMELIMI, EMRI DHE THEMELUESIT

Sot më datë 17.08.2022 themeluesit krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Infinity Holding” sh.p.k, e cila vepron dhe organizohet në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Ortakët themelues të shoqërisë janë:

Znj. Ilda Baraj, shtetase shqiptare, lindur më 27.06.1987, në Fier dhe banuese në Tiranë në adresën: Abdi Kazani; Nd. 13; H. 2; Ap. 13; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia bashkiake nr. 2; 1003; Tiranë madhore me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit Nr. **037362443** dhe Nr. Personal **I75627072N**

Z. Erjon Alimema, shtetas shqiptar, lindur më 13.06.1983. në Tepelenë dhe banues në Tiranë, FREDERIK SHIROKA; Nd. 2; H. 4; Ap. 4; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 7; NJËSIA BASHKIAKE NR. 7; 1023; TIRANË madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit Nr. **037046363** dhe Nr. Personal **I30613084V**



Z. Dorjan Spahiu, shtetas shqiptar, lindur më 23.01.1995 në Peshkopi, Diber dhe banues në Tiranë, me adresen DEDEJ 03860018; Nd. 55/2; H. 1; ; VORË; PICAR; 1032; VORË madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit Nr. BE 680021 dhe Nr. Personal **J50123084N**

NENI 2


OBJEKTI I VEPRIMTARISË


2.1 Objekti i veprimtarisë i shoqërisë “Infinity Holding” sh.p.k është i përgjithshëm dhe do të përfshij por pa u kufizuar në to:

- Agjencitë e pasurive të paluajtshme
- Operacionet e nxjerrjes së zhavorrit dhe rërës, nxjerrja e argjilës dhe kaolinë



- Menaxhimi i pasurive të paluajtshme me pagesë ose kontratë
- Prodhimi i strukturave metalike dhe pjesët e strukturave
- Instalimi i makinerive dhe pajisjeve industriale
- Hotele dhe struktura të ngjajshme
- Blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme në pronësi të vet
- Tregtia me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve hidrosanitare
- Ndërtimi i veprave të tjera të inxhinerisë civile
- Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm
- Dhënia me qira dhe hua e makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit e të punimeve inxhinjerike
- Dhënia me qira dhe hua e kamionëve
- Dhënia me qira dhe hua e mjeteve të transportit
- Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave
- Aktivitete shërbimi të mirëmbajtjes dhe kujdesit të shesheve
- Aktivitete të këshillimit për biznes dhe këshilla të tjera për manaxhimin
- Prodhimi i produkteve prej betoni për qëllime ndërtimi
- Tregtia me shumicë e metaleve dhe mineraleve
- Magazinimi dhe ruajtja
- Nxjerrja nga karriera e gurit dekorativ dhe të ndërtimit, gurit gëlqeror, gipsit, shkumës dhe rrasave
- Të tjera punime të specializuara ndërtimi p.k.t.
- Instalime elektrike
- Punime suvatimi
- Punime montimi
- Punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve
- Vendosja e xhamave
- Punime të tjera përfundimtare dhe finicioni të ndërtesave hi
- Hartimi i projekteve të ndërtimit
- Punime për prishje
- Përgatitja e kantjerit të ndërtimit
- Shpime
- Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale dhe jo rezidenciale
- Ndërtimi i veprave të tubacioneve e kanalizimeve
- Ndërtimi i urave dhe tuneleve
- Ndërtimi i veprave të shërbimit komunal për energjinë elektrike dhe telekomunikacione
- Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit
- Instalime të tjera elektrike





NENI 3 KOHËZGJATJA

- 3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë “Infinity Holding” sh.p.k, është e pakufizuar. Ajo mund të pushojë veprimtarinë e saj në çdo moment, sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve, sipas përcaktimeve ligjore.

NENI 4 SELIA E SHOQËRISË

- 4.1 Selia e shoqërisë “Infinity Holding” sh.p.k është në adresën: *Njësia Administrative nr 5, Rruga “Sami Frashëri”, Dyqani nr.1, Tiranë, Shqipëri.*

NENI 5 DEGËT, ZYRAT E PËRFAQËSIMIT DHE PJESMARRJET

- 5.1 Shoqëria në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi në Shqipëri ose jashtë saj dhe të fillojë dhe/ose të marrë pjesë në aktivitete të tjera të çdo forme.

TITULLI II KAPITALI, KUOTAT

NENI 6 KAPITALI I SHOQËRISË

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1 000 000 (një milion) Lekë, i përbërë nga 3 kuota që në total përbën 100 % te kapitalit themeltar te shoqërisë.
- 6.2 Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortakët e saj si vijon:
- Ortaku themelues Znj. **Ilda Baraj**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 330 000 (treqind e dyzet mijë) lekë që përbën 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.



- Ortaku themelues Z. **Erjon Alimema** zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 330 000 (treqind e tridhjet mijë) lekë që përben 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Ortaku themelues Znj. **Dorjan Spahiu**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 340 000 (treqind e tridhjet mijë) lekë që përben 34% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 7

ÇERTIFIKATAT E KUOTAVE TË KAPITALIT

- 7.1 Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një certifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.

NENI 8

TRANSFERIMI I KUOTAVE, E DREJTA E PARABLERJES

- 8.1 Pjesët/kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme vetëm midis ortakëve ekzistues të shoqërisë.
- 8.2 Nëse secili prej ortakëve dëshiron të shes tërësisht ose pjesërisht kuotën e tij tek një person i tretë jashtë shoqërisë, ai duhet fillimisht t'ua ofroj atë për shitje ortakëve të shoqërisë, në pjesë të barabarta për secilin, me të njëjtin çmim ose çmim më të ulët dhe me të njëjtat kushte që synon ta shes tek të tretët. Oferta duhet tu paraqitet atyre me shkrim ose përmes postës elektronike, me kusht që të konfirmohet marrja.
- 8.3 Nëse ortakët refuzojnë blerjen ose nuk kthejnë përgjigje brenda 30 ditëve nga marrja e ofertës, ortaku ka të drejtë ta shes kuotën e tij tek të tretët, por në çdo rast pasi të ketë marrë pëlqimin unanimit të Asamblesë së Përgjithshme.
- 8.4 Nëse vetëm njëri nga dy ortakët e tjerë refuzon blerjen ose nuk kthen përgjigje brenda 30 ditëve nga marrja e ofertës, ortaku ka të drejtë ti shes kuotën e tij ortakut tjetër që pranon blerjen.
- 8.5 Parashikimet e mësipërme zbatohen edhe në rast të dhurimit apo transferimit në çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji, të ndryshëm nga shitja, të kuotës së njërit prej ortakëve.
- 8.6 Futja e ortakëve të rinj në shoqëri, do të bëhet në çdo rast me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme me vendim unanimit të të gjithë ortakëve të shoqërisë.

8.7 NENI 9

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

- 9.1 Shoqëria me vendim unanim të Asamblesë së Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin, duke rritur numrin e kuotave ekzistuese ose duke rritur vlerën nominale të tyre. I njëjti vendim kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.
- 9.2 Asambleja e shoqërisë mund të vendosi gjithashtu zvogëlimin e kapitalit themeltar me vendim unanim.

**TITULLI III
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

NENI 10

FUNKSIONET DHE MBLEDHJET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

- 10.1 Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

- 10.2 Asambleja e Përgjithshme zhvillon mbledhje të zakonshme dhe mbledhje të jashtëzakonshme sa herë që thirret nga Administratori dhe sa herë ta kërkojnë ortakët në përputhje me Nenin 84 të Ligjit. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën 1 herë në vit sipas Nenit 82 të Ligjit.
- 10.3 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me anë të një njoftimi me shkrim ose një mesazhi me postë elektronike që i drejtohet secilit prej ortakëve. Njoftimi duhet të bëhet jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i cili duhet të përmbajë vendin, datën dhe orën e mbledhjes i dërgohene dhe çështjet dhe dokumentat e rendit të ditës.
- 10.4 Punimet e mbledhjes së asamblese së përgjithshme nuk fillojnë nëse nuk plotësohet kuorumi i parashikuar nga neni 86 i Ligjit.
- 10.5 Në rast se nuk arrihet kuorumi i kërkuar sipas paragrafit të mesipër në mbledhjen e parë, mbledhja e Asamblese së ortakëve shtyhet për një ditë tjetër brenda, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditëve konsektive.
- 10.6 Ortakët ose zotëruesit e prokurave të votimit mund të jenë të pranishëm përmes mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, qoftë kjo përmes lidhjes me audio ose përmes lidhjes me audio dhe video, sipas Nenit 88.
- 10.7 Të pranishmit në Mbledhje caktojnë si Kryetar anëtarin më të vjetër në moshë për të drejtuar punimet e mbledhjes dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes. Procesverbali i mbledhjes, i cili përbën evidentimin *prima facie* të procedimit të mbledhjes, duhet të nënshkruhet nga kryetari i saj dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
- 10.8 Nëse Kryetari i Mbledhjes nuk është i pranishëm, dhe asnjë anëtar tjetër i Asamblesë nuk pranon të jetë Kryetari i mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre për të drejtuar mbledhjen si Kryetar i saj.
- 10.9 Me pëlqimin e pjesëmarrësve në mbledhje, në të cilën është i pranishëm kuorumi, Kryetari mundet (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon asambleja), t'i shtyjë punimet e Asamblesë, por në mbledhjen e shtyrë të Asamblesë nuk mund të diskutohet asnjë pikë me përjashtim të pikave të cilat mund të ishin zgjidhur rregullisht nëse nuk do të ishin ndërprerë dhe shtyrë punimet e Asamblesë. Kur punimet e

Asamblesë janë shtyrë për katërmbëdhjetë ditë ose më shumë, duhet dhënë një njoftim prej të paktën shtatë ditësh të plota në të cilin përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe natyra e përgjithshme e pikave të rendit të ditës që do të diskutohet.




TITULLI IV ADMINISTRATORËT

NENI 11 EMËRIMI I ADMINISTRATORIT

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në këtë document
- 11.2 , nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
- 11.3 Administrator i pare i shoqërisë do të jetë, **Z. Dorjan Spahiu**, shtetas shqiptar, lindur më 23.01.1995 në Diber dhe banues në Tiranë në adresën: DEDEJ 03860018; Nd. 55/2; H. 1; ; VORË; PICAR; 1032; VORË, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letrënjoftimit Nr BE6880021 dhe Nr. Personal **J50123084N** me një kohëzgjatje të ushtrimit të detyrës për pesë vjet, me të drejtë ripërtëritje.

NENI 12 KOMPETENCAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT

- 12.1 Veprimtaria tregtare e shoqërisë drejtohet nga Administratori i cili mund t'i ushtroj të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme nga Ligji ose nga Statuti.
- 12.2 Administratori duhet të marrë paraprakisht miratimin unanimit të Asamblesë së Përgjithshme për kryerjen e çdo veprimi juridik dhe çdo transaksion apo veprim tjetër me vlerë mbi 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lek.



INENI

TITULLI V
DIVIDENDËT DHE KAPITALIZIMI I FITIMEVE


NENI 13
DIVIDENDËT

- 13.1 Pas përmbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- 13.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat në lidhje me të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim me shumat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse kuotat emetohen me kushtin se merr dividend duke filluar nga një datë e caktuar, atëherë kuota në fjalë e merr dividendin sipas këtij kushti.
- 13.3 Asnjë dividend dhe asnjë mjet monetar i pagueshëm në lidhje me një kuotë nuk mund të fitojë interesa nga shoqëria nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i lidhen kuotës.
- 13.4 Nëse një dividend nuk është tërhequr pas dymbëdhjetë vjetëve nga data kur mund të tërhiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është më e detyruar ta paguajë.

TITULLI VI
PRISHJA DHE NJOFTIMET

NENI 14
PRISHJA DHE LIKUIDIMI

- 14.1 Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin, mund t'u shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe, për këtë qëllim, mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.




NENI 15
NJOFTIMET


15.1 Njoftimet që u bëhen ortakëve ose që bëjnë personat sipas Statutit duhet të jenë me shkrim ose me letër rekomande me marrje përgjigje në adresat respektive ose përmes postës elektronike.

ORTAKËT THEMELUES
TË
SHOQËRISË "INFINITY HOLDING" Shpk

DORJAN SPAHIU



ERJON ALIMEMA



ILDA BARAJ

